

VENDIM
Nr. 144, datë 20.2.2013

**PËR PJESËMARRJEN E NJË EKIPI KËSHILLUES USHTARAK (MAT-A) TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË OPERACIONIN USHTARAK “ISAF”,
NË AFGANISTAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një ekipi këshillues ushtarak (MAT-A), të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Kabul, Afganistan, në Komandën Rajonale Qendrore (RC-C/Regional Command Capital), në kuadër të operacionit ushtarak “ISAF”.

2. Përpara dërgimit me mision të ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) në operacionin ushtarak “ISAF” dhe gjatë tij, të zhvillohet në rajonet e zonat e operacionit misioni i rikonicionit, për njohjen e terrenit të veprimit të palëve. Kohëzgjatja e këtij misioni të jetë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe ekipi i rikonicionit të përbëhet nga 4 (katër) ushtarakë të fushave: operacione, zbulim/siguri, logjistikë dhe komunikim.

3. Misioni i ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) është marrja në patronazh për këshillimin, trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të një batalioni të mbështetjes së luftimit të Ushtrisë Kombëtare Afgane, në Komandën Rajonale-Qendrore RC-C, operacioni “ISAF”, në Kabul, Afganistan, duke vepruar dhe kryer detyra operacionale e luftarake, për krijimin e bazave për koordinim, komandim, si dhe zhvillim e mbështetje të planëzimeve në operacion, pjesëmarrje në zhvillimin e operacioneve luftarake e mbështetëse për plotësimin e misionit të Task-Forcës së Aleancës dhe Forcave Afgane të Sigurisë, në qytetin e Kabulit ose rrethinat e tij, duke kontribuar në realizimin e misionit dhe të detyrave operacionale luftarake të Komandës Rajonale-Qendrore (RC-C), operacioni “ISAF”, në Kabul, Afganistan.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor të vitit 2014. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 9 (nëntë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me ekipin e radhës.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesit ushtarakë në përbërje të ekipit këshillues ushtarak (MAT-A), pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) mbështetje shëndetësore;

ç) shërbim telefonik, postar dhe internet;

d) transport;

dh) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

e) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

ë) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në ekipin e rikonicionit, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

- b) sigurimin e jetës;
 - c) mbështetje shëndetësore;
 - ç) shërbim telefonik;
 - d) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
 - dh) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.
8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
9. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha